



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-073

Prishtinë, më 27 gusht 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 27 GUSHT 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Presidenca: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Lejla Selimi.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21 gusht 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 gusht 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 gusht 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi për mbajtjen e mbledhjeve plenare, si vijon:

Mbledhja plenare më 30 gusht 2012, me këtë

R e n d i t e

1. Votimi i tekstit të mocionit të Interpelancës së ministres Mimoza Kusari-Lila, sipas kërkesës së grupit të deputetëve nënshkrues lidhur me vendimin e MTI-së për vendosjen e tarifës prej 35% për importimin e çimentos,
2. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pasurimin e miellit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime,
7. Shqyrtimi i Raportit të dytë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës

për integrim evropian për vitin 2012,

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2011,

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor dhe pasqyrave të audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2011 dhe

10. Debat parlamentar lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, sipas kërkesës së deputetëve nënshkrues.

Gjithashtu, kryetari i njoftoi të pranishmit për vizitën e presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, që do ta realizojë më 30-31 gusht 2012 në Republikën e Kosovës.

Presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga kishte kërkuar nga kryetari i Kuvendit që të thërrasë seancë solemne më 30 gusht 2012, në të cilën presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, me një fjalë rasti do t'u drejtohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Meqë Kryesia më herët e kishte caktuar datën e mbajtjes së mbledhjes plenare për më 30 gusht 2012, Kryesia vendosi që Kuvendi t'i fillojë punimet në orën 10:00, kurse në orën 12:00 të bëhet një pauzë.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, në orën 12:30 minuta, me një fjalë rasti do t'u drejtohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Pastaj, Kuvendi, në orën 14:00, do t'i vazhdojë punimet, sipas rendit të ditës.

Mbledhja plenare më 31 gusht 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Mbledhja plenare më 6 shtator 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekte ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga Shteti,

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat,
10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L- 049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Mbledhja plenare më 7 shtator 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i amendamenteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1 Miratimi i akteve për organizimin dhe klasifikimin e pozitave të Administratës së Kuvendit, sipas sistemit të ri të pagave

Sekretari i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi, i njoftoi në hollësi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit lidhur me organizimin dhe klasifikimin e pozitave të Administratës së Kuvendit, sipas Ligjit për pagat e nëpunësve civilë.

Kryesia, me propozimin e Sekretarit të Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet klasifikimi i vendeve të punës dhe koeficientët për pozitat e nëpunësve të Administratës së Kuvendit, sipas Ligjit për pagat e nëpunësve civilë.
2. Vendimi i dërgohet Ministrisë së Administratës Publike për ekzekutimin e pagave për nëpunësit e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3.2 Kërkesa e Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës për mbështetje financiare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet ndihma financiare Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës në shumën prej 450 euro për zbatimin e projektit: Java ndërkombëtare e njeriut me shkop të bardhë.

3.3 Kërkesa e deputetit Elmi Reçica për lejimin e udhëtimit zyrtar në Slloveni

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Elmi Reçica, në Bled të Sllovenisë, më 2-4 shtator 2012.
2. Nëse organizatori i këtij takimi i mbulon shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurin në paragrafin (1) të këtij vendimi, Kuvendi i Kosovës i kompenson mëditjet shtesë prej 30%.

3.4 Ftesa e Shoqatës humanitare e prindërve të personave me aftësi të kufizuara mendore “Hader” për pjesëmarrje në ekspozitën e organizuar nga kjo shoqatë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me ftesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet ndihma financiare Shoqatës humanitare të prindërve të personave me aftësi të kufizuara mendore “Hader” në Prizren në shumën prej 450 euro, për ekspozitën e punimeve të personave me aftësi të kufizuar mendore.

5. Njoftimi i Komisionit për Integritet Evropian lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Integritet Evropian, të realizuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më 23-25 korrik 2012.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën **11:35** minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale